



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 306/13 Prot.

Lezhë, më 13 / 2 /2026

PROCESVERBAL

- **Titulli i Projektaktit:** Plani Vendor i Veprimit për Migracionin & Diasporën 2026-2030
- **Data dhe Vendi i mbajtjes së takimit:** 12 Shkurt 2026, ora 13:00, ambientet pranë Bibliotekës “Gjergj Fishta”, Kati II-të, Lezhë
- **Pjesëmarrësit në takim nga ana e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore:**
 1. **Z. Ndue Luli** – Kryetar, Këshillit Bashkiak, Lezhë;
 2. **Znj. Florida Çunaj** – Sekretar, Këshillit Bashkiak, Lezhë;
 3. **Znj. Gjuljana Seferaj** – Anëtare e Këshillit Bashkiak, Lezhë;
 4. **Znj. Marte Fetaj** – Drejtor, Drejtoria e Shërbimit & Kujdesit Social;
 5. **Znj. Megi Prela** – Përgjegjës Sektori, Drejtoria Projekteve Strategjike;
 6. **Znj. Amarilda Preçi** – Specialist Migracioni & Diaspora, Drejtoria e Projekteve Strategjike;
- **Territori që mbulon Konsultimi Publik:** Bashkia Lezhë
- **Numri i pjesëmarrësve që marrin pjesë në takim:** 17 (shtatëmbëdhjetë) pjesëmarrës.
- **Numri i femrave që marrin pjesë në takim:** 11 (njëmbëdhjetë) femra.

Takimi u hap nga **znj. Megi Prela, Përgjegjësja e Sektorit** e cila theksoi se **Plani i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030**, është një dokument i rëndësishëm strategjik, me mbështetjen e programit “*Formimi i Migrimit të Orientuar drejt Zhvillimit*” i financuar nga Qeveria Gjermane i zbatuar nga GIZ Shqipëri dhe stafit të Bashkisë Lezhë. Ky plan vjen si përgjigje ndaj nevojës për të menaxhuar më mirë çështjet e migracionit, për të forcuar lidhjet me diasporën tonë dhe

për të krijuar mundësi konkrete zhvillimi për komunitetin vendor. Migracioni mbetet një realitet i rëndësishëm për territorin tonë, ndërsa diaspora përbën një potencial të çmuar për zhvillim ekonomik, social dhe kulturor.

Qëllimi i këtij konsultimi publik është të prezantojmë masat e parashikuara në Planin e Veprimit, por mbi të gjitha të dëgjojmë mendimet, sugjerimet dhe komentet tuaja. Kontributi i aktorëve lokalë dhe i komunitetit është thelbësor për ta bërë këtë dokument sa më realist, të zbatueshëm dhe në përputhje me nevojat e Bashkisë Lezhë. Më pas i dha fjalën **Specialistes së Migracionit dhe Diasporës** në Bashkinë Lezhë, **znj. Amarilda Preçi**.

Znj. Amarilda Preçi – vijoi me prezantimin e Planit të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030, duke theksuar;

1. Objektivat;
2. Qëllimin & Vizionin;
3. Metodologjinë;
4. Analiza Pastel;
5. Roli i bashkisë në çështjet e Migracionit & Diasporës;
6. Fusha e veprimit A: Objektivat;
7. Fusha e veprimit B: Objektivat;
8. Fusha e veprimit C: Objektivat;
9. Monitorizimi & zbatimi i planit.

Prezantimi vijoi duke u ndalur dhe analizuar secilën nga pikat e planit, konkretisht;

1. Objektivi i Përgjithshëm

Forcimi i rolit të pushtetit vendor në menaxhimin e migracionit dhe angazhimin e diasporës, me synim zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të territorit të Bashkia Lezhë.

1.1. Objektivat Specifikë

- Përmirësimi i shërbimeve vendore për emigrantët dhe familjet e tyre.
- Rritja e angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal.
- Forcimi i koordinimit ndërinstytucional për çështjet e migracionit.
- Rritja e kapaciteteve institucionale të bashkisë në fushën e migracionit dhe diasporës.
- Përmirësimi i mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave mbi migracionin në nivel vendor.

2. Metodologjia

Hartimi i Planit të Veprimit është bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke përfshirë:

- **Rishikim dokumentesh:** analiza e legjislacionit kombëtar dhe dokumenteve strategjike.
- **Mbledhje të dhënash:** përdorimi i statistikave vendore dhe kombëtare mbi migracionin.
- **Konsultime me aktorët:** takime me institucione, shoqëri civile, komunitet dhe grupe interesi.
- **Punë në terren:** identifikimi i nevojave konkrete të familjeve të prekura nga migracioni.
- **Validim publik:** organizimi i konsultimit publik për përmirësimin e draftit.

Kjo metodologji siguron që plani të jetë realist, i zbatueshëm dhe i përshtatur me kontekstin lokal.

3. Analiza PESTEL

Analiza PESTEL është përdorur për të vlerësuar faktorët e jashtëm që ndikojnë në migracion dhe diasporë në territorin e bashkisë.

Politike

- Kuadri kombëtar për menaxhimin e migracionit.
- Politikat e integrimit në Bashkimi Evropian.
- Niveli i koordinimit ndërinstytucional.

Ekonomike

- Papunësia dhe mundësitë e kufizuara ekonomike lokale.
- Roli i remitancave nga diaspora.
- Potenciali për investime nga emigrantët.

Sociale

- Plakja e popullsisë dhe largimi i të rinjve.
- Ndikimi i migracionit në strukturën familjare.
- Nevoja për riintegrimin e emigrantëve të kthyer.

Teknologjike

- Digjitalizimi i shërbimeve vendore.
- Përdorimi i platformave online për komunikim me diasporën.
- Kapacitetet ICT të bashkisë.

Mjedisore

- Ndikimi i ndryshimeve klimatike në lëvizjet e popullsisë.
- Menaxhimi i territorit dhe burimeve natyrore.

Ligjore

- Legjislacioni shqiptar për migracionin dhe diasporën.
- Marrëveshjet ndërkombëtare për mobilitetin.
- Detyrimet ligjore të pushtetit vendor.

4. Roli i Bashkisë në Migracion & Diasporë

Bashkia Lezhë ka një rol kyç në:

- Ofrimin e shërbimeve vendore për familjet e emigrantëve.
- Mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave lokale mbi migracionin.
- Lehtësimin e riintegrit të emigrantëve të kthyer.
- Nxitjen e bashkëpunimit me diasporën për investime dhe zhvillim lokal.
- Koordinimin me institucionet qendrore dhe partnerët zhvillimorë.
- Informimin e qytetarëve mbi mundësitë dhe risqet e migracionit.

Bashkia vepron si një lidhëse midis komunitetit lokal, diasporës dhe institucioneve kombëtare.

5. Monitorimi & Zbatimi

Struktura e Zbatimit

- Njësia përgjegjëse brenda bashkisë do të koordinojë zbatimin e planit.
- Do të përcaktohen përgjegjësi të qarta për çdo masë.
- Do të forcohet bashkëpunimi me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë.

Monitorimi

Monitorimi do të realizohet përmes:

- Treguesve të performancës (KPI) për çdo objektiv.
- Raporteve periodike të progresit (6-mujore/vjetore).
- Takimeve të rregullta të grupit të punës.
- Përditësimin të databazës së migracionit.

Vlerësimi

- Vlerësim i ndërmjetëm i zbatimit.
- Vlerësim përfundimtar i arritjes së objektivave.
- Reflektim i mësimave të nxjerra për përmirësime të mëtejshme.

Pas prezantimit të Planit Veprimit të Migracionit dhe Diasporës 2026-2030, vijoi diskutimi nga pjesëmarrësit, konkretisht;

Znj. Madalena Gega - përfaqësuese e OSHC-ve në Lezhë, pyeti se cilat shërbime ofron bashkia Lezhë për emigrantët e rikthyer?!

Znj. Amarilda Preçi – Shërbimet që ofrohen janë; Këshillim për shërbime sociale, mundësi punësimi dhe formim profesional. Ofrim paketave lehtësuese dhe bonuseve të veçanta në periudha të ndryshme periodike gjatë vitit për gratë emigrantë/ të rikthyer, si dhe suport i çështjeve gjinore në bashki, për aksesin në shërbimet publike për grate e kthyer nga emigracioni. Gjithashtu, mbështetje e grupeve të diasporës dhe migrantëve të kthyer përmes ofrimit të paketave fiskale.

Znj. Rejmonda Shyti – Infermiere, pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë (NjVKSH) citoi se ajo ishte një e rikthyer nga emigracioni prej një periudhe prej 10 vitesh në Itali, ku atje ka ushtruar profesionin e saj si infermiere, tha se kishte një plan se si të kontribuonte në Lezhë, duke theksuar dhe eksperiencën e saj në Itali. Plani dhe ideja e saj ishte diskutuar dhe me drejtoreshën e Projekteve Strategjike, bashkinë Lezhë. Kërkonte mbështetje dhe diskutime në tryezë dhe më drejtues të tjerë.

Z. Ndue Luli – Kryetari i Këshillit Bashkiak Lezhë, e falenderoi për pjesëmarrjen e saj në Konsultim Publik. Ai vuri theksin në rëndësinë që kanë konsultimet publike për qytetin dhe banorët e tij/ saj. Ndër të tjera, citoi se mund të drejtohet me shkresë/ email në adresat zyrtare në bashkisë Lezhë për idenë që ta implementonte në territorin e bashkisë Lezhë. Duke qenë se nuk kishte asgjë për të shtuar/ sugjeruar më tej, falenderoi për pjesëmarrjen dhe diskutimin e mbajtur.

Për
Drejtorinë e Projekteve Strategjike,
Evropës, Migracionit, Diasporës,
Komunikimit & Transparencës
Znj. Kiara Alia



Për
Këshillin Bashkiak Lezhë
Znj. Florida Çunaj







